



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 199

Tiranë – E premte, 28 tetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 726, datë 20.10.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, për punësimin me pagë të anëtarëve të familjeve të punonjësve të misionëve zyrtarë të secilit shtet në shtetin tjetër.....
	21671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 727, datë 20.10.2016	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë, në fushën e integritetit evropian.....
	21674
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 728, datë 20.10.2016	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s “Aegean Sea”.....
	21676
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 20.10.2016	Për përcaktimin e tabelave dhe të simboleve në pikat e kalimit kufitar dhe zonat e verifikimit kufitar.....
	21677
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 734, datë 20.10.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar.....
	21686
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 735, datë 20.10.2016	Për miratimin e formatit të Regjistrit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore.....
	21686
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 20.10.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Kongresi i Lushnjës”, pallati 31, tek ish-Kinemaja”, Lushnjë.....
	21691
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.737, datë 20.10.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikim dhe rikonstruksion i Parkut të Dëshmorëve të Kombit, trotuareve dhe unazës perimetrale të tij”, Berat.....
	21692
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 20.10.2016	Për emërim në detyrë.....
	21693

Korrigjim gabimi në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 28.9.2016 "Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ansambl i rilindjes urbane, Belsh", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186, datë 6 tetor 2016..... 21693



VENDIM

Nr. 726, datë 20.10.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË FRANCËS, PËR
PUNËSIMIN ME PAGË TË ANËTARËVE
TË FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË
MISIONEVE ZYRTARE TË SECILIT
SHTET NË SHTETIN TJETËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, për punësimin me pagë të anëtarëve të punonjësve të misioneve zyrtare të secilit shtet në shtetin tjetër, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FRANCEZE NË LIDHJE ME
PUNËSIMIN ME PAGË TË ANËTARËVE TË
FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË MISIONEVE
ZYRTARE TË SECILIT SHTET NË SHTETIN
TJETËR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Francës, më poshtë të quajtura “Palët”,

duke marrë në konsideratë interesin për t’u lejuar anëtarëve të familjeve në ngarkim të punonjësve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të dërguara me mision zyrtar në territorin e Palës tjetër, për të ushtruar lirisht aktivitete profesionale, në bazë të një trajtimi reciprok;

me dëshirën për të lehtësuar ushtrimin e një aktiviteti profesional me pagë për anëtarët e familjeve në shtetin pritës;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Autorizim për të ushtruar aktivitete me pagë

Personat në ngarkim të personelit diplomatik, konsullor, teknik dhe administrativ të caktuar me mision zyrtar nga qeveria e tyre në shtetin tjetër janë të autorizuar të ushtrorjnë një veprimtari profesionale me pagë në shtetin pritës, në të njëjtat kushte me shtetasit e atij shteti, me kusht që të respektojnë ligjet dhe rregullat për ushtrimin e profesionit të tyre, me të marrë autorizimin e kërkuar në përputhje me çka parashikohet në këtë marrëveshje.

Neni 2

Përkufizime

Kuptimet e shprehjeve sipas kësaj marrëveshjeje janë si më poshtë:

a) Termi “misione zyrtare” do të thotë misionet diplomatike të rregulluara nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike, e 18 prillit 1961, postet konsullore të rregulluara nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, e 24 prillit 1963, dhe përfaqësitë e përhershme të secilit prej dy shteteve pranë organizmave ndërkombëtarë që kanë nënshkruar marrëveshje selie me shtetin tjetër;

b) Termi “anëtar i një misioni zyrtar” do të thotë: personel i shtetit dërgues, që nuk është as shtetas, as rezident i përhershëm në shtetin pritës, që ka funksion zyrtar në një mision diplomatik, në një post konsullor ose në një përfaqësi të përhershme të shtetit dërgues në shtetin tjetër.

c) Termi “person në ngarkim”, do të thotë:

Për Palën Shqiptare:

1. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët, të cilët janë pjesë e përhershme e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo posteve konsullore në shtetin pritës.

Për Palën Franceze:

1. Bashkëshorti/ja i/e të njëjtut seks ose me seks të ndryshëm ose partneri i lidhur me një kontratë bashkimi civil, me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze;

2. Fëmijët beqarë më të vegjël se 21 vjeç, që jetojnë në ngarkim të prindërve dhe në të njëjtën banesë, përfshirë këtu dhe ata që ndjekin studimet në shkolla të larta të njohura nga secili shtet, me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze; dhe



3. Fëmijët beqarë që jetojnë në ngarkim të prindërve dhe paraqesin një aftësi të kufizuar fizike ose mendore, por që mund të punojnë, pa u bërë kështu një barrë e shtuar financiare për shtetin pritës, dhe që janë të pajisur me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze.

d) “Aktivitet profesional me pagë” do të thotë: çdo aktivitet që shpërblehet me një pagë të parashikuar në një kontratë pune në përputhje me legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 3

Procedurat

a) Punësimi i një personi në ngarkim për të ushtruar një aktivitet profesional me pagë ose vetëpunësimi në shtetin pritës varet nga autorizimi i dhënë paraprakisht nga autoritetet kompetente, nëpërmjet një kërkesë dërguar në emër të personit në ngarkim, nga Ambasada e tij në protokollin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës. Kërkesa duhet të saktësojë aktivitetin profesional që personi në ngarkim dëshiron të ushtrojë, adresën e punëdhënësit të mundshëm dhe çdo informacion të kërkuar gjatë procedurës dhe në formularët e autoritetit përkatës, si dhe shumën e pagës së parashikuar. Autoritetet kompetente të shtetit pritës, pasi verifikojnë nëse personi në ngarkim i plotëson kushtet e nevojshme të parashikuara në këtë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi, informon zyrtarisht Ambasadën e shtetit dërgues, nëpërmjet protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës që personi në ngarkim është i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi në shtetin pritës.

b) Pas tre muajsh nga data e marrjes së autorizimit për të ushtruar një aktivitet profesional, Ambasada u dërgon autoriteteve kompetente të shtetit pritës provën që personi në ngarkim dhe punëdhënësi i tij u përgjigjen detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni i shtetit pritës në lidhje me mbrojtjen sociale.

c) Në rastet kur personi në ngarkim dëshiron të ndryshojë punëdhënësin pasi ka marrë një autorizim punësimi, ai duhet të paraqesë një kërkesë të re për autorizim.

d) Në rastet kur personi në ngarkim dëshiron të ndryshojë aktivitetin profesional vetëpunësimi, ai duhet të paraqesë një kërkesë të re për autorizim.

e) Autorizimi për të ushtruar një aktivitet profesional nuk do të thotë që personi në ngarkim është i çliruar nga çdo kërkesë, procedurë ose detyrim që normalisht vlen për këtë punë, qoftë në lidhje me karakteristika personale, me diploma ose kualifikime profesionale ose të tjera. Në rastet kur kemi të bëjmë me profesione të rregulluara, për të cilat autorizimi i ushtrimit mund të jepet vetëm në funksion të disa kritereve, personi në ngarkim është i detyruar t'i përmbushë këto kritere.

f) Autorizimi mund të refuzohet në rastet kur mund të punësohen vetëm shtetasit e shtetit pritës për arsye që lidhen me sigurinë ose me rendin publik.

g) Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk kanë të bëjnë me njohjen reciproke midis dy shteteve të diplomave, të nivelit ose të studimeve të kryera.

h) Autorizimi për t'u punësuar, që i jepet një personi në ngarkim të një punonjësi të misionit, është i vlefshëm deri në përfundimin e mandatit të këtij punonjësi ose deri kur përfituesi nuk konsiderohet më person në ngarkim.

i) Megjithatë, është marrë në konsideratë një afat i arsyeshëm, i parashikuar në nenet 39.2 dhe 39.3 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike dhe nenet 53.3 dhe 53.5 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore. Aktiviteti profesional i ushtruar në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk autorizon dhe as u jep të drejtë personave në ngarkim të vazhdojnë të banojnë në territorin e shtetit pritës, si dhe nuk i autorizon ata ta ruajnë këtë vend pune apo të fillojnë një punë tjetër në këtë shtet pas përfundimit të afatit të autorizimit.

Neni 4

Imuniteti civil ose administrativ

Në rastin e personave në ngarkim, që gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil ose administrativ i shtetit pritës, në përputhje me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 ose të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963, ky imunitet nuk zbatohet në rastin e një veprimi ose mosveprimi të kryer gjatë aktivitetit profesional, si dhe kur ky aktivitet parashikohet nga juridiksioni civil ose administrativ i shtetit pritës.



E njëjta gjë parashikohet edhe në rastin e imunitetit nga ekzekutimi, i cili nuk zbatohet në rast të një padie të lidhur me këtë aktivitet profesional.

Neni 5

Imuniteti penal

Në rastin e personave në ngarkim që përfitojnë nga një imunitet juridik penal i shtetit pritës, sipas Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 ose të asaj mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963 ose çdo tekst tjetër ndërkombëtar i zbatueshëm:

a) Dispozitat në lidhje me imunitetin e juridiksionit penal të shtetit pritës vazhdojnë të zbatohen për rastet e një veprimi të kryer gjatë aktivitetit profesional.

b) Por, në rastet e kundërvajtjeve të rënda, të kryera në kuadrin e aktivitetit profesional, shteti dërgues, me kërkesë me shkrim të shtetit pritës, duhet të marrë në konsideratë seriozisht heqjen e imunitetit të personit në ngarkim të implikuar ndaj juridiksionit penal të shtetit pritës.

c) Heqja dorë nga imuniteti i juridiksionit penal nuk do të ketë të bëjë me ekzekutimin e vendimit. Prandaj është e nevojshme që dorëheqja të jetë e specifikuar. Në raste të tilla, shteti dërgues do të marrë seriozisht në konsideratë heqjen dorë nga ky imunitet.

Neni 6

Regjimi tatimor dhe sigurimet shoqërore

Në bazë të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 dhe në bazë të dispozitave të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963, për personat në ngarkim zbatohet legjislacioni përkatës në lidhje me regjimin tatimor dhe sigurimet shoqërore të shtetit pritës, për sa u përket aktiviteteve të tyre profesionale me pagë në këtë shtet.

Personi në ngarkim i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional, nuk përfiton, duke filluar nga data e autorizimit, nga lehtësirat doganore të parashikuara nga nenet 36 dhe 37 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike, nga neni 50 i Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore ose nga marrëveshje që kanë të bëjnë me selinë e organizatave ndërkombëtare.

Personi në ngarkim, i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional sipas kësaj marrëveshjeje,

mund të transferojë të ardhurat dhe fitimet dytësore në të njëjtat kushte, siç parashikohet nga rregullorja e shtetit pritës për punonjësit e huaj.

Neni 7

Ushtrimi i një aktiviteti vetëpunësimi

Në rastin e një aktiviteti profesional vetëpunësimi, kërkesat e personave në ngarkim për të ushtruar këtë lloj aktiviteti profesional shqyrtohen, rast pas rasti, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat e shtetit pritës.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje, zgjidhet me negociatë të drejtpërdrejta mes Palëve në rrugë diplomatike.

Neni 9

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, me anë të të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave kushtetuese dhe ligjore të brendshme të nevojshme për miratimin e saj.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin reciprok të Palëve. Ndryshimi hyn në fuqi sipas afateve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një afat të pacaktuar. Megjithatë, ajo mund të zgjidhet në çdo moment nga njëra nga Palët, me shkrim dhe në rrugë diplomatike. Në këtë rast, ajo përfundon 6 (gjashtë) muaj pas kërkesës për zgjidhjen e saj.

Bërë në Tiranë, më 19.9.2016, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhët shqip dhe frëngjisht, të dyja versionet të barasvlershme ligjrisht.

**VENDIM****Nr. 727, datë 20.10.2016****PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
BULLGARISË, NË FUSHËN E
INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë, në fushën e integrimit evropian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NË FUSHËN E INTEGRIMIT EVROPIAN
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
BULLGARISË**

Duke synuar nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis njëri-tjetrit,

duke ndarë vlerat dhe parimet e Bashkimit Evropian (BE),

duke pasur parasysh se Republika e Bullgarisë është anëtare e Bashkimit Evropian dhe se qëllimi strategjik i Republikës së Shqipërisë është që t’i bashkohet Bashkimit Evropian,

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të nënshkruar ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve anëtare të tyre, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër,

duke përshëndetur progresin e arritur nga Republika e Shqipërisë në rrugën e saj të integrimit evropian dhe dhënien e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE, në qershor 2014,

Faqe | 21674

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë (më pas të referuara si “Palët”), kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët angazhohen të nxisin bashkëpunimin ndërmjet tyre në fushën e integrimit evropian, të fokusuar në përgatitjen e suksesshme të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 2

Palët bashkëpunojnë për të arritur një ndërgjegjësim më të madh shoqëror në Republikën e Shqipërisë drejt vlerave evropiane, si dhe për të arritur mënyrat më efikase të bashkëpunimit midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Palët do të bashkëpunojnë për të promovuar mjetet më të mira të ndërgjegjësimit publik për të sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në anëtarësimin me të drejta të plota në BE.

Neni 3

Bashkëpunimi përqendrohet në të gjitha fushat përkatëse për procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë, duke mbështetur përpjekjet e saj për t’u bërë anëtare me të drejta të plota të Bashkimit Evropian nëpërmjet statusit të kandidatit dhe negociatave për anëtarësim. Në veçanti:

1. Në lidhje me dëshirën e Republikës së Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Republika e Bullgarisë është e gatshme të ofrojë ndihmë në nivel ekspertësh në lidhje me përvojën e Bullgarisë në miratimin dhe zbatimin e *acquis communautaire* (legjislacionit komunitar).

2. Republika e Bullgarisë shpreh gatishmërinë për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta mes institucioneve bullgare dhe shqiptare në lidhje me forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare.

3. Republika e Bullgarisë është e gatshme të ndajë përvojën e saj në procesin e negociatave për bisedimet e aderimit në Bashkimin Evropian, si dhe asistencë ekspertësh për administratën shqiptare në këtë fushë.

4. Republika e Bullgarisë është e gatshme të ndajë përvojën e saj në përdorimin e fondeve/instrumenteve të paraaderimit, duke përfshirë zbatimin e projekteve infrastrukturore evropiane në procesin e përgatitjes për anëtarësim me të drejta të plota.



5. Republika e Bullgarisë është e gatshme të ndajë përvojën dhe pikëpamjet e saj në fushën e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian në lidhje me nevojën e vendeve kandidatë që i bashkohen qëndrimeve të përbashkëta të BE-së.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e përcaktuara në nenin 3, me anë të:

1. Organizimit të aktiviteteve të përbashkëta: takime, seminare, tryeza të rrumbullakëta, forume me ekspertë dhe zyrtarë nga të dyja palët.

2. Trajnimit përmes seminareve, kurseve dhe praktikave mësimore mbi çështje të integritetit evropian.

3. Fillimit të aktiviteteve të binjakëzimit për ndihmë administrative të kolegëve dhe bashkëpunim në instrumentet Tweening (binjakëzimi), Taix dhe Sigma dhe kërkimin e mundësive për bashkëpunim në të gjitha fushat në programet e BE-së.

4. Shfrytëzimit të aftësive të Institutit Diplomatik të ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë për trajnimin e personelit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në fushën e integritetit evropian.

5. Ndarjes së përvojës dhe praktikave të mira të identifikuar në procesin e negociatave të anëtarësimit të Bullgarisë në BE.

Neni 5

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e financimit të veprimeve të vendosura me këtë memorandum, duke përdorur mekanizmat e bashkëpunimit dhe financimit institucional të disponueshëm në kuadër të Bashkimit Evropian.

Neni 6

Palët mund të përgatitin plane vjetore për zbatimin e këtij memorandumi.

Neni 7

Palët mund të informojnë institucionet evropiane për bashkëpunimin e tyre dypalësh.

Neni 8

Kushtet e këtij memorandumi nuk mund të jenë në kundërshtim me ndonjë marrëveshje ekzistuese ose të ardhshme ndërmjet Palëve. Ky

memorandum nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Zbatimi i memorandumit kryhet nga secila prej Palëve, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar dhe rregulloret administrative, dhe në kuadër të kompetencave dhe burimeve të tyre të disponueshme.

Neni 9

Ky memorandum do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të të cilit secila Palë Kontraktuese njofton palën tjetër përmes kanaleve diplomatike se kërkesat e tyre ligjore të brendshme për hyrjen në fuqi të këtij memorandumi janë plotësuar.

Neni 10

Ky memorandum nënshkruhet për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) me zgjatje automatike me periudha njëvjeçare.

Ky memorandum mund të përfundohet nga secila Palë me njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër përmes kanaleve diplomatike, me një periudhë njoftimi prej 6 (gjashtë) muajsh.

Neni 11

Ky memorandum mund të ndryshohet me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 12

Pas përfundimit të këtij memorandumi, dispozitat e tij do të vazhdojnë të zbatohen për projekte dhe kontrata që janë ende në proces, të filluara dhe të përfunduara në bazë të këtij memorandumi deri në përfundimin e tyre, në rast se nuk është rënë dakord ndryshe nga Palët.

Nënshkruar në Sofje, më 17 maj 2016, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, ku të tria tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndryshimeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ditmir Bushati

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË BULLGARISË

Daniel Mitov

**VENDIM****Nr. 728, datë 20.10.2016****PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E
NATO-s “AEGEAN SEA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s “Aegean Sea”, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë dhe 1 (një) anije e klasit “Iliria”.

2. Misioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2, në detin Egje, në kuadër të operacionit të NATO-s “Aegean Sea”.

3. Kohëzgjatja e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion është deri në 1 (një) vit, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të anijes dhe kontingjentit të parë, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrës në këtë operacion, do të jetë çdo 2 (dy) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin e kontingjentit të radhës (marrje dhe dorëzim detyrë, vonesa të transportit strategjik etj.).

4. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë në detin Egje.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, të përballojë shpenzimet, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) akomodim;

d) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

dh) mbështetje shëndetësore;

e) telefon, komunikim SATCOM, internet, shërbim postar;

ë) sigurimin e anijes;

f) karburant, lubrifikantë;

g) shërbime lundrimi (taksa portuale, pilot, ujë, derdhje të ujërave të zeza, akostim qëndrimi, lavanteri etj.);

gj) mirëmbajtjen teknike dhe riparime të anijes, të paparashikuara;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare gjatë kohës së kryerjes së misionit;

j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit të anijes që do të marrë pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe ku pala/ët tjetër/e tjera merr/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë operacion.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 729, datë 20.10.2016****PËR PËRCAKTIMIN E TABELAVE DHE
TË SIMBOLEVE NË PIKAT E KALIMIT
KUFITAR DHE ZONAT E VERIFIKIMIT
KUFITAR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zona e verifikimit kufitar shënohet me tabela në gjuhët shqip dhe anglisht, siç paraqitet në shtojcën 1/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, përkatësisht në:

a) çdo hyrje të territorit të portit dhe aeroportit që është pikë e kalimit kufitar;

b) në rastin e pikave tokësore të kalimit kufitar, në të gjitha rrugët automobilistike që çojnë në pikën përkatëse të kalimit kufitar, në vendin që korrespondon me fillimin e zonës së verifikimit kufitar, sipas përcaktimit të nenit 10, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”.

2. Pikat e kalimit kufitar shënohen me tabela në gjuhët shqip dhe anglisht, siç tregohet në shtojcën 1/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në rastin e pikave të kalimit kufitar me orar të kufizuar, nën tabelën e parashikuar në pikën 2 vendoset një tabelë shtesë që paraqet orarin zyrtar, sipas modelit të shtojcës 1/c, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në rast të kufizimeve për personat e mjetet dhe në varësi të kufizimit përkatës, një tabelë shtesë në shqip dhe anglisht, sipas modelit të shtojcës 1/ç, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, vendoset nën tabelën e përmendur në pikën 3 ose, në mungesë të kësaj të fundit, nën tabelën e përmendur në pikën 2.

5. Zonat e transitit në aeroporte dhe porte shënohen me tabela në gjuhët shqip dhe anglisht,

siç tregohet në shtojcën 1/d, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Hyrja në Republikën e Shqipërisë dhe dalja nga Republika e Shqipërisë në pikat e kalimit kufitar shënohen përkatësisht me tabela në gjuhët shqip dhe anglisht, sipas përcaktimit në tabelat 1 dhe 2, të shtojcës 2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për personat që, sipas parashikimeve të nenit 14, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, janë subjekt i verifikimit minimal, përcaktohen korsi të veçanta që shënohen në gjuhët shqip dhe anglisht, siç tregohet në tabelën 1, të shtojcës 2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Personat e lartpërmendur, krahas këtyre korsive, mund të përdorin gjithashtu korsitë e parashikuara në pikat 5 dhe 6, të këtij vendimi.

8. Bazuar në nevojat praktike për të huajt, që nuk kanë nevojë për vizë dhe për të huajt që posedojnë leje qëndrimi ose vizë afatgjatë të vlefshme, mund të përcaktohen korsi të veçanta të cilat shënohen në gjuhët shqip dhe anglisht, siç tregohet në tabelën 3 të shtojcës 2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Këta persona, krahas këtyre korsive, mund të përdorin gjithashtu korsitë e parashikuara në pikën 6, të këtij vendimi.

9. Për të gjithë personat e tjerë, të cilët nuk përmenden në pikën 7 ose 8, të këtij vendimi, përcaktohen korsi të veçanta që shënohen në gjuhët shqip dhe anglisht, siç tregohet në tabelën 2, të shtojcës 2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Në pikat portuale dhe ato tokësore të kalimit të kufirit, në varësi të nevojave praktike, mund të përcaktohen korsi të veçanta për autovetura, kamionë dhe autobusë. Këto korsi shënohen në gjuhët shqip dhe anglisht, siç tregohet në tabelat e shtojcës 2/c, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Pika 3, e vendimit nr. 1018, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e standardeve dhe të kritereve të kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

12. Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 9, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, ngarkohen, përkatësisht:

a) operatorët e aeroporteve për pikat aeroportuale dhe autoritetet portuale për pikat

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.



portuale të kalimit kufitar, për sigurimin e tabelave të parashikuara në këtë vendim;

b) Autoriteti Rrugor Shqiptar për sigurimin e tabelave të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, për pikat tokësore të kalimit kufitar;

c) Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme, sipas përgjegjësisë së administrimit

të territorit të pikës së kalimit kufitar, për sigurimin e tabelave të parashikuara në këtë vendim për pikat e kalimit kufitar tokësor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca 1/a

ZONË E VERIFIKIMIT KUFITAR
BORDER CHECK ZONE

Shtojca 1/b

PIKA E KALIMIT KUFITAR
XXXXXXX
BORDER CHECK POINT

Shtojca 1/c

ORARI ZYRTAR
OFFICIAL WORKING HOURS
:00 - :00



Shtojca 1/ç

NUK LEJOHEN AUTOMJETET
VEHICLES NOT PERMITTED

Shtojca 1/d

ZONË TRANSIT
TRANSIT ZONE



Shtojca 2/a

Tabela 1





Tabela 2





Shtojca 2/b

Tabela 1



Tabela 2





Tabela 3

***NUK KËRKOHET
VIZË***

***VISA
NOT REQUIRED***

Shtojca 2/c

Tabela 1



Tabela 2




Tabela 3




Tabela 4

NUK KËRKOHET VIZË VISA NOT REQUIRED	 VETURA CARS
--	--

Tabela 5


NUK KËRKOHET VIZË VISA NOT REQUIRED	 KAMIONA LORRIES
--	---

Tabela 6

NUK KËRKOHET VIZË VISA NOT REQUIRED	 AUTOBUZA BUSES
--	---

Tabela 7

TË GJITHA PASAPORTAT ALL PASSPORTS	
---	--

Tabela 8


